



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, kërkon ekspertë të kualifikuar/arkitekt për krijimin e një biblioteke për qëllime studimore dhe rikonceptim të recepsionit të AMA-s.

TERMAT E REFERENCËS

Qëllimi

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në përmirësim të cilësisë të aktivitetit të tij, si dhe për të inkurajuar e forcuar partneritetin me institucionet publike, akademike dhe shoqërinë civile, ndër vite u ka dhënë hapësirë e ka mbështetur financiarisht realizimin e projekteve, studimeve dhe përkthimeve të literaturave të munguara botërore në fushën e medias. Shumë prej projekteve, në përfundim të tyre, shoqërohen edhe me botime të ndryshme. Botimet dhe broshurat, një pjesë u shpërndahen subjekteve audiovizive dhe grupeve të interesit dhe një pjesë pasurojnë bibliotekën e institucionit.

Në kushtet kur në AMA mungon një hapësirë për pasqyrimin e plotë të këtyre botimeve, kërkojmë krijimin e një biblioteke/hapësire të dedikuar studimore, mbajtjen, ekspozimin, sistemimin e botimeve të AMA-s, duke rikonceptuar njëkohësisht edhe recepsionin e institucionit.

Detyrat

Eksperti i kualifikuar/arkitekti i përzgjedhur do të punojë në bashkëpunim me stafin e AMA-s për të realizuar detyrat e mëposhtme:

1. Të realizojë koncept idenë/planin e arredimit dhe preventivin përkatës, brenda afatit, 10 (dhjetë) ditor nga data e nënshkrimit të kontratës.
2. Koncept idea/plani i arredimit të jetë i qartë dhe të përmbushë kërkesat e institucionit për këtë qëllim.
3. Preventivi të përfshijë zërat e nevojshëm për krijimin e një biblioteke për qëllime studimore dhe rikonceptim të recepsionit të AMA-s

Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga aplikuesit për ekspert të kualifikuar në fushën e arredimit të ambienteve të brendshme:

1. CV ku përfshihen të dhëna të detajuara mbi angazhimin në punë të ngjashme.
2. Licencë profesionale (kopje e njehsuar me origjinalin)
3. Kopje të ID /NIPT

Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ekspertit të kualifikuar/arkitektit:

Eksperienca mbi 3 vjet në projektim e arredim të ambienteve të brendshme. **40 pikë**

Portofol i punëve të realizuara **60 pikë**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 24 Nëntor 2021, ora 12:00, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, nr.15, Tiranë.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 08.11.2021